



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE**  
**УСТАВНИ СУД**  
**CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 4 tetor 2011

Nr. ref.: RK 140/11

## **AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**Rastin Nr. KI 106-10**

Parashtrues

**Binak Thaqi**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme P. nr. 610/07;  
Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Ap. nr. 267/08; Aktgjykimit të Gjykatës  
Supreme Pn. nr. 311/10; dhe Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Pn. nr. 572/10**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar  
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar  
Robert Carolan, gjyqtar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Ivan Čukalović, gjyqtar  
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe  
Iliriana Islami, gjyqtare

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Parashtrues është Binak Thaqi, nga Gjakova, i përfaqësuar nga avokati Mustafë Kastrati nga Peja.

## **Vendimet e kontestuara**

2. Parashtruesi i konteston vendimet e Gjykatës së Qarkut në Pejë (P. nr. 610/07. Tri aktgjykime ishin lëshuar nën këtë numër të vendimit në datat në vijim: 21 nëntor 2007, 8 prill 2010 dhe 1 shtator 2010) dhe vendimet e Gjykatës Supreme (Ap. nr. 267/08; të 25 shtatorit 2008, Pn. nr. 311/10; të 12 korrikut 2010; dhe Pn. nr. 572/10, të 5 tetorit 2010).

## **Objekti i çështjes**

3. Çështja ka të bëjë me dënimin e parashtruesit në Gjykatën e Qarkut në Pejë, më 21 nëntor 2007, për vrasje dhe mbajtje në pronësi, kontroll, posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve.

## **Baza juridike**

4. Neni 113.7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), neni 20 i Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe neni 56.2 i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja).

## **Procedura në Gjykatë**

5. Parashtruesi e parashtrroi kërkesën në Sekretariatën e Gjykatës Kushtetuese më 21 tetor 2010.
6. Me urdhër të Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese, Zëvendëskryetari Kadri Kryeziu u caktua Gjyqtar raportues. Kryetari i Gjykatës Kushtetuese e caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Almiro Rodrigues (kryesues), Ivan Čukalović dhe Iliriana Islami.
7. Më 14 qershor 2011, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues, u këshillua për këtë çështje dhe i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë.

## **Përmbledhja e fakteve**

8. Parashtruesi u dënua për vrasje sipas nenit 146 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës dhe për mbajtje në pronësi, kontroll, posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve sipas nenit 328 (2) të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës në Gjykatën e Qarkut në Pejë më 21 nëntor 2007. Provat e shqyrtuara që shpuren në dënimin e tij u sqaruan gjerësisht në Vendimin e Gjykatës Supreme.
9. Parashtruesi, që atëherë përfaqësohej nga avokati i tij mbrojtës Enver Nimani, parashtrroi ankesë më 21 prill 2008 në Gjykatën Supreme të Kosovës kundër këtij dënimi duke u mbështetur në një sërë bazash. Këto baza përfshinin keqinterpretimin nga Gjykata të një numri të madh të fakteve dhe arritjen në konkluzione të shumta të gabuara. Në ankesë gjithashtu pohohej që vetëmbrojtja nuk ishte konsideruar drejt nga Gjykata e Qarkut. Ankesa përmbante deklaratën se *“vdekja e të ndjerit, si rrjedhojë e plumbave të shkrepur nga revolja e Binak Thaqit, me duart e tij, në mënyrë të padiskutueshme ...”*.
10. Ankesa gjithashtu i referohej dënimit me burg për të dy akuzat, duke theksuar se dënimet ishin shumë të ashpra.

11. Më 25 shtator 2008, Gjykata Supreme e Kosovës e hodhi poshtë ankesën si të pabazë dhe e miratoi aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut. Gjykata Supreme gjithashtu e hodhi poshtë ankesën kundër ashpërsisë së dënimeve.
12. Më 14 gusht 2009, parashtruesi, i përfaqësuar nga avokati Mustafë Kastrati, paraqiti një propozim në Gjykatën e Qarkut në Pejë me të cilin kërkonte rihapjen e procedurës. Baza përfshinte, por nuk ishte e kufizuar në, faktin që ekzistonte një raport i pakompletuar i autopsisë lidhur me shkaqet e vdekjes dhe se raporti i autopsisë ishte vetëm në gjuhën angleze. Gjykata e Qarkut, me vendimin e 8 prillit 2010, e hodhi poshtë kërkesën për rihapjen e procedurës penale dhe theksoi se çështja ishte *res judicata*.
13. Në bazë të ankesës nga ky vendim i Gjykatës së Qarkut, Gjykata Supreme, me vendimin e 12 korrikut 2010, e refuzoi ankesën si të pabazë.
14. Parashtruesi më pas parashtrroi kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën e Qarkut, që doli nga shkeljet e supozuara të Kodit Penal, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Kartës për të Drejtat e Njeriut [sic] dhe kërkoi që procedura të rihapej. Më 1 shtator 2010, Gjykata e Qarkut e hodhi poshtë këtë kërkesë si të papranueshme.
15. Parashtruesi paraqiti ankesë kundër këtij vendimi në Gjykatën Supreme më 6 shtator 2010. Gjykata Supreme e refuzoi ankesën si të pabazë më 5 tetor 2010.

### **Pretendimet e parashtruesit**

16. Në kërkesë pohohet që janë shkelur këto të drejta të garantuara me Kushtetutë: neni 5 [Gjuhët], neni 24.2 [Barazia para Ligjit], neni 30.1 [Të Drejtat e të Akuzuarit], neni 31.1.4 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], dhe neni 32 [E Drejta për Mjete Juridike].
17. Substanca e kërkesës varet nga pohimi se raporti i autopsisë për të ndjerin ishte në gjuhën angleze dhe jo në gjuhën shqipe, dhe që parashtruesi i kërkesës dhe avokati i tij nuk kishin mundësi ta vinin atë në dyshim apo t'u shtronin dëshmitarëve pyetje në mënyrë të kryqëzuar në lidhje me të.

### **Vlerësimi paraprak i pranueshmërisë së kërkesës**

18. Kriteret për pranueshmëri janë të përcaktuara në Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
19. Nenet 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës përcaktojnë kornizën e përgjithshme juridike që kërkohet për pranueshmëri. Neni 113.1 thotë:

*1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*

Neni 113.7 thotë:

*"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike dhe të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."*

20. Për më tepër, neni 48 i Ligjit thotë:

*"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".*

21. Së fundi, rregulli 36 i Rregullores së punës thotë:

*“1. Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:  
c) kërkesa është qartazi e bazuar.*

*2. Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar nëse bindet se:*

*a) kërkesa nuk arsyetohet prima facie, ose*

*b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese, ose*

*c) Gjykata gjen se parashtruesi nuk është subjekt i ndonjë shkeljeje të së drejtave të garantuara me Kushtetutë, ose*

*d) kur parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.*

22. Neni 35.1 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore thotë që Gjykata Evropiane mund ta trajtojë çështjen vetëm pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet e brendshme ligjore.

23. Gjykata Kushtetuese e Kosovës e zbatoi arsyetimin e shterimit të mjeteve juridike në Rastin Nr. KI 41/09, Universiteti AAB-RIINVEST L.L.C., kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës, dhe në Rastin Nr. KI 73/09, Mimoza Kusari-Lila kundër Komisionit Qendror Zgjedhor.

24. Në këto raste, Gjykata theksoi se arsyetimi për rregullin e shterimit të mjeteve juridike është që t'ua lejojë autoriteteve në fjalë, duke përfshirë gjykatat e rregullta, mundësinë për ta parandaluar ose korrigjuar shkeljen e supozuar të Kushtetutës. Ky rregull bazohet në supozimin se rendi juridik i Kosovës do të sigurojë mjet efikas juridik për shkeljen e të drejtave kushtetuese (shih, *mutatis mutandis*, GJEDNJ, Selmouni kundër Francës, Nr. 25803/94, Vendimi i 28 korrikut 1999).

25. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut e shtjelloi rëndësinë e këtij koncepti me sa ka të bëjë me ngritjen e shkeljeve të supozuara me rastin e shterimit të mjeteve të brendshme juridike para dorëzimit të një kërkesë në Gjykatë, në Selmouni kundër Francës (Nr. 25803/94, vendimi i 28 korrikut 1999), duke diskutuar qëllimin e nenit 35 [Kriteret e Pranueshmërisë] dhe supozimin e mjeteve juridike, duke theksuar:

*“... Prandaj, ankesa e menduar për t'iu parashtruar më pas Gjykatës duhet së pari t'i jetë parashtruar – së paku në substancë – organit përkatës vendës dhe në përputhje me kriteret formale dhe afatet kohore të përcaktuara në ligjin vendës (shih Cardot kundër Francës, aktgjykimi i 19 marsit 1991, Seria A nr. 200, f. 18, paragrafi 34).”*

26. Gjykata Kushtetuese e Kosovës e zbatoi këtë arsyetim në Rastin KI 07/09 (Demë dhe Besnik Kurbogaj kundër Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Pkl. nr. 61/07, dhe Aktgjykimit të Gjykatës Supreme nr. Ap. nr. 510/07) për t'i gjetur të papranueshme pretendimet e parashtruesit për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë për shkak të kërcënimit të dëshmitarëve nga policia dhe prokuroria, duke thënë:

*“... as në vendimin e bashkëngjitur të Gjykatës së Qarkut të Pejës, as në vendimet e Gjykatës Supreme nuk mund të gjendet asnjë referencë për këtë ngjarje. Në anën tjetër, askund nuk përmendet kundërshtimi i bërë gjatë seancës dëgjimore lidhur me shkeljen e supozuar dhe, nëse ka pasur, cili ishte mjete juridik.*

*Prandaj, kërkesa nuk përmban informacione dhe dokumente të nevojshme mbështetëse për ta provuar supozimin. Siç duket, parashtruesi në të vërtetë nuk*

*e kundërshtoi shkeljen dhe prandaj hoqi dorë nga e drejta për t'u thirrur tani në një shkelje të tillë, nëse ka”.*

27. Siç u theksua në faktet më sipër, e tërë kërkesa tani përqendrohet në faktin që raporti i autopsisë ishte në gjuhën angleze dhe që parashtruesi nuk kishte pasur mundësi ta kuptonte përmbajtjen e tij apo të shtronte pyetje në mënyrë të kryqëzuar lidhur me të. Megjithatë, parashtruesi nuk tregon cila provë në raportin e autopsisë do të kishte pasur vlerë përkatëse provuese për të hedhur dyshim në aktgjykimin origjinal dhe në dënimin për vrasje dhe përdorim të paautorizuar të armës. Për më tepër, argumentet e parashtruesit në këtë fazë lidhur me rëndësinë e asaj se çfarë mund të jetë në raport të autopsisë dobësohen dukshëm nga pranimet e parashtruesit se “vdekja e të ndjerit, si rrjedhojë e plumbave të shkrepur nga revolva e Binak Thaqit, me duart e tij, në mënyrë të padiskutueshme ...”.
28. Gjykata Kushtetuese e Kosovës nuk e gëzon juridiksionin e apelit dhe nuk mund të ndërhyjë nga aspekti teorik nëse gjykatat e tilla kanë marrë vendim të gabuar ose kanë bërë vlerësim të gabuar të fakteve. Roli i Gjykatës Kushtetuese është vetëm që ta sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat që garantohen me Kushtetutë dhe instrumente të tjera ligjore dhe prandaj nuk mund të veprojë si “gjykatë e shkallës së katërt”, (shih, *mutatis mutandis*, ndër të tjera, Akdivar kundër Turqisë, 16 shtator 1996, R. J. D, 1996-IV, para. 65).
29. Përveç kësaj, Gjykata vëren që nuk ka prova në kërkesë për të sugjeruar që parashtruesi e kundërshtoi raportin e autopsisë në gjuhën angleze, mungesën e tij në gjuhën shqipe, apo mundësinë e tij të humbur për ta vënë në pyetje raportin apo për t'u parashtruar dëshmitarëve pyetje në mënyrë të kryqëzuar lidhur me të gjatë gjykimin fillestar në Gjykatën e Qarkut në Pejë. As këto çështje nuk janë ngritur në ankesën e parashtruesit, të 21 prillit 2008, drejtuar Gjykatës Supreme.
30. Në bazë të arsytimit të mësipërm, kërkesa është qartazi e pabazuar.

### **PËR KËTO ARSYE**

Në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe rregullin 56 (2) të Rregullores së punës, Gjykata Kushtetuese, me shumicë

### **VENDOS**

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Gjyqtari raportues**

Kadri Kryeziu



**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Prof. Dr. Enver Hasani